



PSH.nr.861/20

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Goran Milenković - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “PROing”Sh.p.k & Partners” Sh.p.k.–Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik “AL Engineering”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Hartimi-përpilimi i projekteve ideore dhe zbatuese, me nr. të prokurimit: 631-20-1872-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Kuvendi Komunal – Deçan, më datën: 23.11.2020, mori këtë:

## V E N D I M

**I. APROVOHET**, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “PROing”Sh.p.k & Partners” Sh.p.k.–Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi-përpilimi i projekteve ideore dhe zbatuese, me nr. të prokurimit: 631-20-1872-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Kuvendi Komunal – Deçan.

**II. ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi-përpilimi i projekteve ideore dhe zbatuese, me nr. të prok: 631-20-1872-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Kuvendi Komunal – Deçan, dhe lënda kthehet në **rivlerësim**.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “PROing”Sh.p.k & Partners” Sh.p.k.–Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues “PROing”Sh.p.k & Partners” Sh.p.k.–Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 29.10.2020 me nr. 861/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi-përpilimi i projekteve ideore dhe zbatuese, me nr. të prokurimit: 631-20-1872-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Kuvendi Komunal – Deçan, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 13, 59, 61, 62, 64 dhe 57 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 39 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 30.10.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 06.11.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim:

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE i rekomanduar për kontratë Operatori ekonomik AL ENGINEERING SH.P.K. ka prezantuar Certifikatën e Licencës së Projektit imë afat te skaduar.

Operatori ekonomik AL ENGINEERING SH.P.K. në hapjen e ofertave ka prezantuar licence e softuerit me numrat: 8987-10644. Nëse e shohim data kur është licencuar ky operator ekonomik (subscription start) është 29.03.2017 ndërsa data e skadimit të licencës (subscription end) është 28.03.2018.

Operatori ekonomik AL ENGINEERING SH.P.K. e ka prezantuar licencën e softuerit me validitet të skaduar dhe siç mund të shihen kjo licence ka qenë valide vetëm deri me datën 28.03.2018, pra data e skadimit është



me shume se 2 vite. Ne këtë rast ky OE është dashur te shpallet i papërgjegjshëm sipas nenit 59 par. 4 te LPP-se sepse nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e FDT-se dhe njoftimit për kontrate.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmimeve të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne kërkesat mbi mundeshit teknike dhe/ose profesionale **te FDT-së**, si ne vijim:

Kërkesa 5.Operatori ekonomik duhet te ketë licenë te softwert per projektimin e rrugëve	Dëshmia 5. Kopje e licenses.
---	------------------------------

OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ka ofruar Licencën e softuerit me nr. 8987-10644, e cila është e lëshuar me dt. 29.03.2017, ndërsa si date e skadimit shënon dt. 28.03.2018, bazuar ne kërkesën e FDT-se si me larte është kërkuar Kopja e licencës, nuk është kërkuar validiteti, prandaj ky pretendim (është i njëjta), objekt i kontestit dhe palët janë te njëjta, dhe pasi ne shqyrtimin ma pare është rekomanduar nga eksperti shqyrtues, qe AK mund te veproj konform nenit 59.2 dhe 72 te LPP-së. Mirëpo kërkesa e përcaktuar nga AK ne FDT, është kërkuar vetëm kopje e licencës, pa përcaktuar afatin e validitetit te kësaj Licence. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **pjesërisht i është i qëndrueshëm**.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, Autoriteti kontraktues e ka rekomanduar për kontrate operatorin ekonomik AL ENGINEERING SH.P.K. i cili ka ofruar me çmime ab-normalisht te ulëta.

Në vijim është tabela me përlllogaritjet e çmimeve:

Nr.				
	A	B	C	D
1	<b>kushti 1 - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar 3 oferta</b>	<b>Pranuar 3 oferta</b>		
2	PRO ing & Partners Sh.p.k. & Fidan Hasanaj B.I. & Artings Projekt Sh.p.k.	1	1.28	Oferta 1
3	AL ENGINEERING SH.P.K.	2	0.53	Oferta 2
4	Infra-Plus Sh.p.k.	3	1.58	Oferta 3
5		<b>Total (C1+C2+C3)</b>	<b>3.39</b>	
6		<b>Mesatarja (C8/3)</b>	<b>1.13</b>	
7		<b>30% i mesatares (C6*30%)</b>	<b>0.34</b>	
8	<b>kushti 2 - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin</b>	<b>pragu 30% (C6-C7)</b>	<b>0.79</b>	<b>në këtë rast vetëm oferta 2 përmbush</b>

	kushtin e dytë			kushtin e dytë prandaj vazhdohet me kushtin e tretë
9		10% ne mes dy ofertave (C2*10%)	0.13	
10	kushti 3 – pragu 10% në mes ofertës më të lirë në krahasim me ofertën e dytë më të lirë	pragu 10% ((C2-C9)	1.15	në këtë rast oferta 2 përmbush edhe kushtin e tretë

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi
1	Jenë pranuar me shume se 3 oferta	Është plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 3 oferta
2	Çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulet se çmimi mesatar i tenderëve te përgjegjshëm	Oferta e dyte plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulet se mesatarja e tenderëve. Shih prapun ne kolonën C8
3	Çmimi i ofruar është me shume se 10% me i ulet se çmimi ose kostot e tenderit te dyte me te ulet.	Oferta e dyte plotëson edhe kushtin e trete (10%) sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shume se 10% me i ulet. Shih prapun C10
Konkludim	Oferta me nr. rendor 2 plotëson 3 kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhoje mund te konsiderohet si ofertë ab-normalisht e ulët.	

Nga kjo tabelë shihet qarte qe autoriteti kontraktues e ka rekomanduar për kontrate operatorin ekonomik i cili ka ofertuar me çmime ab-normalisht te ulëta, dhe ne tabelën ne te cilën ne i kemi bere llogaritjet ashtu siç parashihet tek Neni 3 tek *Rregullorja për Tenderët Jo-normalisht te Ulet*, janë përmbushur tri kushtet e parashikuar, prandaj tenderi i OE te rekomanduar për kontrate është tender jo-normalisht i ulet. Ne këtë rast autoriteti kontraktues nuk e ka zhvilluar procedurën ne pajtim me nenin 3 siç parashihet tek Rregullat për Tenderët Jo-normalisht te Ulet, andaj AK-ja ne këtë rast nuk e ka marr për baze nenin 61 te LPP-se dhe nuk i është përmbajtur ne detaje Rregullores për Tenderët Jo-normalisht te Ulet.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmimeve te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, kur kemi kriterin çmimi me i lire i poentuar nga AK duhet te eliminohet praktikat kur çmimi e një ofertuesi e krahason me çmimin e ofertuesit tjetër, pasi qe kriteri i tille kërkon qe çmimet e poentuar te bazohen ne çmimin e ofertuar, e jo duke krahasuar çmimet me ofertues tjerë, sepse ne rast kur kemi krahasimin e çmimeve me oferta te ndryshëm me njëra – tjetrën, atëherë kemi te bëjmë me kriterin çmimi me i ulet, pra tek kriteri tenderi me çmimin me te ulet te poentuar, pavarësisht çmimit te ofertës për njësi sepse kemi te bëjmë me kontrate kornize , ku nuk kemi sasi indikativë. Prandaj ne këtë kuptim sqarohet se



Rregullorja për tenderët jo normalisht të ulët gjë zbatim të kriteri “Çmimi më i ulët” por jo edhe tek kriteri çmimi m% i ulët i poentuar. Duke u bazuar në këto fakte dhe duke pasqyruar kërkesën e AK të lartpërmendur dhe analizës së mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë nuk është i qëndrueshëm.

#### Përgjigje në Pretendim nr. 3

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në listën e stafit, për kërkesën në lidhje me: një inxhinier i gjeodezisë ose bachelor i Inxhinierisë së ndërtimit dhe arkitekturës drejtimi Gjeodezi me përvojë pune profesionale minimum 3 vite ka ofruar inxhinierin z. Nevzat Piraj ku nëse shikojmë diplomën e tij, ajo nuk është përkthyer në njërin nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. Në këtë rast autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 13 Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik, konkretisht paragrafi 13.4 i LPP-së specifikon: *Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze.* Përkthimi duhet të jetë para datës së hapjes së ofertave, gjë që OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi që e posedon përkthimin e diplomës para hapjes së ofertave. Madje AK nuk mund të kërkojë informacione sqaruese lidhur me këtë pikë pasi që neni 72.2 të LPP-së sqarimet duhet të kërkojnë në pajtim me nenet 65-71 të LPP-së, ndërsa në rastin konkret përdorimi i gjuhëve zyrtare bën pjesë në nenin 13 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të **FDT-së**, si në vijim:

Kërkesa 6. Një Inxhinier i Gjeodezisë ose bachelor i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Arkitekturës drejtimi Gjeodezi me përvojë pune profesionale minimum 3 vite.	Dëshmia 6 • Diplomat-kopje (të diplomuarit jashtë vendit, diploma të jetë e nostrifikuar në Kosovë) • CV-të -të nënshkruara nga Inxhinieri
--	--

OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar për inxhinierin z. Nevzat Piraj, duke ofruar diplomën kopje të lëshuar nga Shkolla e Lartë Gjeodezike në Beograd, me datë 12.10.198, në alfabetin Çirilik, pra në gjuhën Serbe, me noterizim kopje të bërë me datë 24.02.2014, me nr. LRP-588/14, duke pasqyruar se dorëzimi i dokumenteve përmes platformës elektronike, dokumentet nuk janë origjinale, por janë të skanuara. Duke u bazuar në këto fakte dhe duke pasqyruar kërkesën e AK të lartpërmendur dhe analizës së mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë nuk është i qëndrueshëm.

#### Përgjigje në Pretendim nr. 4

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm pasi nuk ka plotësuar siç duhet formularin e tenderit. Në dosjen e tenderit konkretisht

ne pjesën e FDT-se konkretisht ne nenin 21.1 Periudha e vlefshmërisë se tenderit është cekur validiteti i ofertave 60 dite, ndërsa OE i rekomanduar për kontrate ne formularin C e ka validitetin e ofertave ne periudhën 90 dite, ne këtë rast nuk është plotësuar formulari i tenderit siç duhet , ndërsa Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP) neni 39 Sqarimi i tenderëve paragrafi 39.8 përshkruan dhe përcakton qarte:

*Formulari i tenderit nuk është plotësuar siç duhet - refuzo tenderin pa kërkuar informacione te mëtejshëm – Kusht Administrativ.*

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, AK ne njoftimin për kontrate dhe ne dosjen e tenderit, ka përcaktuar se periudha e vlefshmërisë se tenderit është: **60 dite**, duke filluar si numër i ditëve kalendarike nga afati i fundit për dorëzimin e tenderëve. Ndërsa OE i rekomanduar për kontrate, ka ngarkuar formularin e tenderit te gjeneruar nga platforma elektronike, ku ne piken 4 shkruan: “**Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 90 nga data finale për dorëzim të tenderëve**”, që do të thotë se operatori ekonomik ka ofruar vlefshmërinë e tenderit për **90 dite**, dhe plotëson kërkesën e vlefshmërisë se tenderit te përcaktuar nga autoriteti kontraktues në periudhe prej 60 dite.

Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **nuk është i qëndrueshëm**

Përgjigje në Pretendimi Nr. 5

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 1, 7, 59 dhe 60 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet ne harmoni te plote me dispozitat ligjore te LPP-se, dhe te trajtoj dhe analizoj çmimin e secilit operator ekonomik ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 ne dosje te tenderit.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në **nenin 6 të LPP-së**, autoriteti kontraktues duhet të këtë ne konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.



Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe te gjeturat tjera në këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues, të aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe rekomandon të mbetet në fuqi vendimi - B58-njoftimit mbi vendimin AK (rekomandimi për dhënie të kontratës).

Autoriteti Kontraktues me datë 06.11.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik me datë 08.11.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në konfirmojmë pranimin e emailit dhe në nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues z. Sahit Beqiri pasi që mendojmë që nuk ka dhënë mendim profesional për pretendimet tona ankimore.

Sa i përket përgjigjes në pretendimin ankimor **Nr.1** eksperti shqyrtues në njërin anë e vërteton që operatori ekonomik AL Engineering SH.P.K e ka ofruar licencën e softuerit me licencë të skaduar pra afati I skadimit të licencës është më shumë se dy vite nga hapja e ofertave, ndërsa në anën tjetër thekson që në dosjen e tenderit nuk është kërkuar validiteti i licencës dhe këtë pretendim tonin e cilëson si pjesërisht të qëndrueshëm.

Në nuk pajtohemi me këtë mendim të ekspertit shqyrtues pasi që edhe siq mund të shihet licenca e softuerit është me afat të skaduar pra më shumë se dy vite dhe edhe pse në dosjen e tenderit nuk është specifikuar validiteti i licencës ajo nënkuptohet që çdo dokument i prezantuar në hapjen e ofertave duhet të jetë valid dhe me afat brenda kohës së vlerësimit të ofertave.

Sa i përket përgjigjes në pretendimin ankimor **Nr.2** ku eksperti thekson që rregullorja për tenderët abnormalisht të ulët nuk aplikohet kur kriter është tenderi me çmimin më të ulët me poentim. Në nuk pajtohemi me këtë mendim pasi që kriteri kryesor i vlerësimit të ofertave në këtë aktivitet të prokurimit ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët. Kjo është specifikuar në dosjen e tenderit konkretisht në pjesën e FDT-së pika 30.1 Kriterit e dhënies.

Në bazë të kësaj vërtetohet që duhet aplikuar rregullorja për tenderët abnormalisht të ulët dhe AK ja në këtë rast nuk e ka marrë për bazë nenin 61 të LPP-së dhe nuk i është përmbajtur në detaje Rregullores për Tenderët Jo-normalisht të Ulët.

Sa i përket përgjigjes në pretendimin ankimor **Nr.3** ku eksperti rekomandon që është jo i qëndrueshëm pasi që diploma është në gjuhën serbe në alfabetin Çirilik. Në nuk pajtohemi me këtë mendim pasi që Operatori

Ekonomik AL Engineering në listën e stafit ka prezantuar z. Nevzat Piraj ku nëse shikojmë diplomën e tijë ajo nuk është e përkthyer në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

Në këtë rast Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të Nenit 13 Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik, konkretisht paragrafi 13.4 i LPP-se specifikon: Një operator ekonomik mun ta paraqesë një tender një kërkesë për pjsmarrje apo apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze .Përkthimi duhet të jetë para datës së hapjes së ofertave, gjë që OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi që e posedon përkthimin e diplomës para hapjes së ofertave. Madje AK nuk mund të kërkojë informacione sqaruese lidhur me këtë pikë pasi që në nenin 72.2 të LPP-së sqarimet duhet të kërkojnë në pajtim me nenet 65-71 të LPP-së, ndërsa në rastin konkret përdorimi i gjuhëve zyrtare bënë pjesë në nenin 13 të LPP-së. Madje në vendimet e mëhershme të OSHP-së vërtetohet një gjë e tillë përshembull vendimi i panelit shqyrtues me numër 60-63/20 ka këtë vendim:

Lidhur me pretendimin e ankuesit se AK-ja , gjatë fazës së rivlerësimit, në kundërshti me dispozitat e LPP-së ka kërkuar sqarim, konkretisht ka kërkuar nga OE I rekomanduar për kontratë diplomën e përkthyer në njërën nga gjuhët zyrtare. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se është I qëndrueshëm ky pretendim I OE ankues për faktin se sipas nenit 72.2 sqarimet duhet të kërkojnë në pajtim me nenet 65-71 të LPP-së, ndërsa në rastin konkret përdorimi I gjuhëve zyrtare bënë pjesë në nenin 13 të LPP-së.

Në fund kërkojmë nga paneli shqyrtues që pretendimet tona ankimore ti marrë si të bazuara dhe këtë aktivitet të prokurimit ta kthejë në rivlerësim.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 23.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “PROing”Sh.p.k & Partners” Sh.p.k.–Prishtinë, se OE i rekomanduar për kontratë AL ENGINEERING SH.P.K. ka prezantuar certifikatën e licencës së projektit me afat të skaduar. Operatori ekonomik AL ENGINEERING SH.P.K. ne hapjen e ofertave ka prezantuar licencën e softuerit me numrat: 8987-10644. Nëse e shohim data kur është licencuar ky operator ekonomik (subscription start) është 29.03.2017 ndërsa data e skadimit të licencës (subscription end) është 28.03.2018. Operatori ekonomik AL ENGINEERING SH.P.K. e ka prezantuar licencën e softuerit me validitet të skaduar dhe siç mund të shihen kjo licencë ka qene valide vetëm deri me datën 28.03.2018, pra data e skadimit është



me shume se 2 vite. Ne këtë rast ky OE është dashur të shpallet i papërgjegjshëm sipas nenit 59 par. 4 të LPP-së sepse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe njoftimit për kontratë.

Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka kërkuar tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të FDT-së, si ne vijim:

Kërkesa 5.Operatori ekonomik duhet te ketë licenë te softëert per projektimin e rrugëve	Dëshmia 5. Kopje e licenses.
---	------------------------------

Për këtë kërkesë të AK-së, OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar licencën e softuerit me nr. 8987-10644, e cila është e lëshuar me dt. 29.03.2017, ndërsa si datë e skadimit shënon dt. 28.03.2018. Pra, duke pasur parasysh kërkesën e AK-së për licencë ndërsa AK ka dorëzuar licencë e cila ka skaduar me datë 28.03.2018 nënkupton që i njëjti nuk ka fare licencë. Andaj, ky pretendim ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “PROing”Sh.p.k & Partners” Sh.p.k.–Prishtinë, se autoriteti kontraktues e ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik AL ENGINEERING SH.P.K. i cili ka ofruar me çmime ab-normalisht te ulëta, duke i bashkangjitur tabelat me kalkulime sikurse në ankesë e parashtruar nga OE ankues, duke shtuar se nga tabela shihet qartë që autoriteti kontraktues e ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik i cili ka ofertuar me çmime ab-normalisht te ulëta, dhe në tabelën në të cilën ne i kemi bërë llogaritjet ashtu siç parashihet tek Neni 3 tek *Rregullorja për Tenderët Jo-normalisht te Ulët*, janë përmbushur tri kushtet e parashikuara, prandaj tenderi i OE te rekomanduar për kontrate është tender jo-normalisht i ulët. Ne këtë rast autoriteti kontraktues nuk e ka zhvilluar procedurën ne pajtim me nenin 3 siç parashihet tek Rregullat për Tenderët Jo-normalisht te Ulet, andaj AK-ja ne këtë rast nuk e ka marr për baze nenin 61 te LPP-se dhe nuk i është përmbajtur ne detaje Rregullores për Tenderët Jo-normalisht te Ulet.

Paneli Shqyrtues sqaron se në rastet kur kemi kriterin çmimi më i lirë i poentuar nga AK duhet të eliminohet praktikat kur çmimi e një ofertuesi e krahason me çmimin e ofertuesit tjetër, pasi që kriteri i tille kërkon që çmimet e poentuara të bazohen në çmimin e ofertuar, e jo duke krahasuar çmimet me ofertues tjerë sepse në rast kur kemi krahasimin e çmimeve me oferta të ndryshëm me njëra – tjetrën, atëherë kemi të bëjmë me kriterin çmimi më i ulët. Pra, tek kriteri tenderi me çmimin më të ulët të poentuar, pavarësisht çmimit të ofertës për njësi sepse kemi të bëjmë me kontratë kornize, ku nuk kemi sasi indikative. Prandaj, në këtë kuptim sqarohet se Rregullorja për tenderët jo normalisht të ulët gjen zbatim te kriteri “Çmimi më i ulët” por jo edhe tek kriteri çmimi më i ulët i poentuar. Andaj, pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “PROing”Sh.p.k & Partners” Sh.p.k.–Prishtinë, se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në listën e stafit, për kërkesën në lidhje me: një inxhinier i gjeodezisë ose bachelor i Inxhinierisë se ndërtimit dhe arkitekturës drejtimi Gjeodezi me përvoja pune

profesionale minimum 3 vite ka ofruar inxhinierin z. Nevzat Piraj, ku nëse shikojmë diplomën e tij, ajo nuk është përkthyer ne njërën nga gjuhët zyrtare te Republikës se Kosovës. Ne këtë rast autoriteti kontraktues ka bere shkelje te nenit 13 Përdorimi i gjuhëve ne dokumentet e prokurimit publik, konkretisht paragrafi 13.4 i LPP-se specifikon: *Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze.* Përkthimi duhet te jete para datës se hapjes se ofertave, gjë qe OE i rekomanduar për kontrate nuk ka ofruar dëshmi qe e posedon përkthimin e diplomës para hapjes se ofertave. Madje AK nuk mund te kërkoj informacione sqaruese lidhur me këtë pike pasi qe neni 72.2 te LPP-se sqarimet duhet te kërkojen ne pajtim me nenet 65-71 te LPP-se, ndërsa ne rastin konkret përdorimi i gjuhëve zyrtare bene pjese ne nenin 13 te LPP-së.

Paneli Shqyrtues sqaron se bazuar në kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të FDT-së, AK ka kërkuar si në vijim:

Kërkesa 6. Një Inxhinier i Gjeodezisë ose bachelor i Inxhinierisë se Ndërtimit dhe Arkitekturës drejtimi Gjeodezi me përvoja pune profesionale minimum 3 vite.	Dëshmia 6 • Diplomat-kopje (te diplomuarit jashtë vendit, diploma te jetë e nostrifikuar ne Kosovë) • CV-të -të nënshkruara nga Inxhinieri
--	--

OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ka ofruar për inxhinier te Gjeodezisë z. Nevzat Piraj, duke ofruar diplomën kopje të lëshuar nga Shkolla e Lartë Gjeodezike në Beograd, me datë 12.10.198, në alfabetin Çirilik, pra në gjuhen Serbe, me noterizim kopje të bërë me datë 24.02.2014, me nr. LRP-588/14. Po ashtu, duhet pasur parasysh që dorëzimi i dokumenteve përmes platformës elektronike, dokumentet nuk janë origjinale por janë te skanuara. Pra, pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “PROing” Sh.p.k & Partners” Sh.p.k.–Prishtinë, se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm pasi nuk ka plotësuar siç duhet formularin e tenderit. Ne dosjen e tenderit konkretisht ne pjesën e FDT-se konkretisht ne nenin 21.1 Periudha e vlefshmërisë se tenderit është cekur validiteti i ofertave 60 dite, ndërsa OE i rekomanduar për kontrate ne formularin C e ka validitetin e ofertave ne periudhën 90 dite, ne këtë rast nuk është plotësuar formulari i tenderit siç duhet, ndërsa Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP) neni 39 Sqarimi i tenderëve paragrafi 39.8 përshkruan dhe përcakton qarte:

*Formulari i tenderit nuk është plotësuar siç duhet - refuzo tenderin pa kërkuar informacione te mëtejshëm – Kusht Administrativ.*

Paneli Shqyrtues sqaron se AK në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, ka përcaktuar se periudha e vlefshmërisë së tenderit është: 60 ditë, duke filluar si numër i ditëve kalendarike nga afati i fundit për dorëzimin e tenderëve. Ndërsa, OE i rekomanduar për kontratë ka ngarkuar formularin e tenderit të gjeneruar nga platforma elektronike, ku në piken 4 shkruan: “Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose



dite: 90 nga data finale për dorëzim të tenderëve”, që do të thotë se operatori ekonomik ka ofruar vlefshmërinë e tenderit për 90 dite, dhe plotëson kërkesën e vlefshmërisë së tenderit të përcaktuar nga autoriteti kontraktues në periudhë prej 60 ditë. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe shkresave të lëndës, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk ka bërë ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit dhe në harmoni me nenin 59 të LPP-së për shkak se ka rekomanduar operatorin ekonomik i cili ka dorëzuar licencë me afat të skaduar. Andaj, obligohet AK që gjatë rivlerësimit të tenderëve të zbatoj dispozitat e LPP-së, konkretisht të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së, si dhe duke pasur parasysh kërkesat e dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t’i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



#### **Vendimi t’i dorëzohet:**

- 1x1 AK “Kuvendi Komunal – Deçan”;
- 1x1 OE “PROing” Sh.p.k & Partners” Sh.p.k.–Prishtinë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.